



Periodiku AMF

Roli i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në funksion të mbrojtjes konsumatore

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, si institucion i pavarur, ka funksion licencues, rregullues dhe mbikëqyrës të tregut financiar jo-bankar, ku përfshihet dhe veprimtaria e shoqërive të sigurimit.

Vijon në faqen 2

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

Vështrim mbi tregun e sigurimeve për vitin 2009

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për vitin 2009 arritën shifrën 7,889,428 mijë lekë përkundrejt 7,089,541 mijë lekë të realizuara në vitin 2008 ose 11.28 % më shumë.

Vijon në faqen 3

Zhvillimet e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për vitin 2009

Tregu sekondar i letrave me vlerë të Qeverisë gjatë vitit 2009 u dominua në masën 89.41% nga transaksionet në instrumenta afatshkurtër (bono thesari) dhe 10.59% nga instrumenta afatgjatë (obligacione).

Vijon në faqen 6

Zhvillimet e tregut të pensioneve vullnetare private për vitin 2009

Tregu i pensioneve vullnetare mbetet ende një treg i vogël, por ky si nga këndvështrimi i kontributeve dhe nga numri i kontribuesve. Në këtë treg, për vitin 2009, shihet një rritje prej 37.26% e kontributeve

dhe një rritje prej afër 14.71% e numrit të kontribuesve, krahasuar me vitin 2008.

Vijon në faqen 7

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

Zhvillohet seminari për Marrëveshjen Multilaterale të Mirëkuptimit me IAIS (Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve)

Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) në bashkëpunim me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare të Hungarisë (HFSA), zhvilloi në datën 29 janar 2010 në Budapest, seminarin për Marrëveshjen Multilaterale të Mirëkuptimit (MMoU) me IAIS.

Vijon në faqen 8

Edukimi i konsumatorit

Drejtimi i brendshëm i shoqërive të sigurimit dhe administrimi i riskut

(Material i marrë nga botimi i Bankës Botërore "Mbikëqyrja e Bazuar në Risk", me autor Tony Randle, dhjetor 2009)

Mbikëqyrja e Bazuar në Risk, për Autoritetet Rregullatore të Sigurimeve

Roli i autoriteteve rregullatore që kanë detyrën e mbikëqyrjes së matur, është nxitja e mbajtjes së tregjeve efçente, të drejta, të sigurta dhe të qëndrueshme të sigurimeve, në të mirë dhe mbrojtje të policmbajtësve. Një autoritet mbikëqyrës i efektshëm është në gjendje t'i kërkojë një shoqërie sigurimesh marrjen e masave parandaluese dhe korrigjuese në kohë nëse kjo shoqëri nuk e ushtron aktivitetin në përputhje me praktikën e shëndosha tregtare apo me kërkesat rregullatore.

Vijon në faqen 9

Në këtë numër:

Roli i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në funksion të mbrojtjes konsumatore

2

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

3

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

8

Edukimi i konsumatorit

9

Roli i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në funksion të mbrojtjes konsumatore

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, si institucion i pavarur, ka funksion licencues, rregullues dhe mbikëqyrës të tregut financiar jo-bankar, ku përfshihet dhe veprimtaria e shoqërive të sigurimit. AMF, me anë të mjeteve ligjore, administrative dhe informacionit, mbron konsumatorin, si dhe ruan stabilitetin në fushën financiare jo-bankare.

Veprimtaria e AMF-së, në funksion të mbrojtjes konsumatore, përqendrohet në marrëdhënien me siguruesit.

Të gjithë hallkat e strukturës organizative të AMF-së, drejtpërdrejt ose indirekt, janë në funksion të mbrojtjes së konsumatorit. Përveç kësaj, funksionon dhe një strukturë e veçantë siç është *njësia e mbrojtjes konsumatore*.

Mjetet në funksion të mbrojtjes konsumatore janë: Informimi në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim që konsumatori të jetë në gjendje të përzgjedhë për llojet e produkteve që ofrohen, mbulimet e këtyre produkteve, përfitimet, etj.

Në bazë të legjislacionit në fuqi, shoqëritë e sigurimit janë të detyruara të informojnë publikun për kushtet e kontratave të sigurimit, në lidhje me produktet e sigurimit, me zgjidhjen e plotë dhe të pjesshme të kontratës, përfitimet që rrjedhin nga kontrata e sigurimit, primet, etj.

AMF, në mënyrë të vazhdueshme, informon konsumatorin nëpërmjet medias së shkruar vizive dhe faqes së internetit, që është instrumenti kryesor i komunikimit me gjithë palët e interesit, me informacione të rëndësishme që lidhen me aktivitetin e tij.

Shoqëritë e sigurimit kanë detyrim ligjor të publikojnë të dhëna si: Raportet periodike financiare së bashku me një raport të

përmbledhur të auditimit, si dhe raporte statistikore.

AMF praktikon një sërë formash dhe mënyrash për një komunikim efektiv dhe transparent me publikun, si p.sh: fletë palosje që përmbajnë informacion të bollshëm edukativ dhe statistikor për tregjet nën juridiksionin e tij, raporte statistikore periodike, raport i mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve, gjeografia e sigurimeve, raport vjetor, etj.

Funksioni i njësisë konsumatore dhe masat e marra më qëllim mbrojtjen e tyre

Mbi bazën e kuadrit ligjor dhe një metodologjie të përcaktuar, njësia konsumatore, trajton në mënyrë profesionale, të paanshme dhe të shpejtë, të gjithë ankesat që vijnë nga ankimues të ndryshëm, për rastet kur personi mbetet i pakënaqur në lidhje me afatet, procedurat e ndjekura nga shoqëria e sigurimit apo masën e dëmshpërblimit të ofruar.

Përveç kësaj, kjo njësi i asiston personave të interesuar duke i sqaruar në lidhje me të gjithë paqartësitë që ka konsumatori, duke filluar nga kontrata e sigurimit e në vazhdim.

Gjithashtu, në ndihmë të konsumatorit, në faqen zyrtare të AMF-së, çdo person i siguruar mund të verifikojë nëpërmjet Qendrës Kombëtare të të dhënave të sigurimit, vlefshmërinë e policës së tij të sigurimit.

Në faqen zyrtare të Autoritetit janë publikuar numri telefonik i konsumatorit, si dhe numri jeshil, me qëllim mundësimin e shërbimeve pa pagesë nga ana e konsumatorëve. Për këtë qëllim, është ngritur një sistem ku përfundojnë linjat telefonike të cilësuar më sipër, menaxhohen mesazhet zanore, mesazhet e regjistruara, si dhe menaxhohet ndërlidhja e telefonatave me sektorët e institucionit.

Si vepron konsumatori ne rastet kur ai nuk është në gjendje të përzgjedhë situatën që i paraqitet.

Konsumatori, për rastet kur ngjarja ka ndodhur dhe ai nuk është në gjendje ta zgjidhë, mund t'i drejtohet menjëherë Autoritetit, si nëpërmjet adresës së konsumatorit që gjendet në faqen zyrtare të AMF-së, ashtu dhe në mënyrë verbale.

Mund të përmendim rastet kur konsumatori ka hasur probleme dhe është i paqartë në lidhje me kushtet e kontratave të sigurimit, rastet kur ai është dëmtuar dhe nuk është në gjendje të përcaktojë vendin ku do paraqitet apo dokumentat që duhet të plotësojë (këtu përmendim në veçanti rastet kur të dëmtuari i është shkaktuar dëm nga një mjet i pasiguruar).

Autoriteti ka licencuar vlerësuesit e dëmeve, nëpërmjet të cilëve behet vlerësimi i dëmit të ndodhur, si material apo shëndetësor. Këta vlerësues, si të pavarur, ashtu dhe pranë shoqërive të sigurimit, mbikëqyren nga AMF për veprimtarinë e tyre. Për pasojë, çdo shkelje që mund të konstatohet gjatë vlerësimit të dëmit, bëhet objekt i sanksioneve të parashikuara në ligj.

Konsumatori, nëse nuk mbetet i kënaqur me vlerësimin e bere nga shoqëria e sigurimit, mund t'i drejtohet një vlerësuesi të pavarur.

Të rejat që ka sjellë ligji i ri i sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit.

Ligji i ri i sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit, sjell rritjen e gamës së produkteve të sigurimit të detyrueshëm, si sigurimi i pasagjerëve në aksidentet në transportin publik, sigurimi i përgjegjësishë së pronarit të avionit, apo të mjetit lundrues.

Përveç dëmit material dhe shëndetësor, ligji parashikon edhe demin jo-pasuror (moral, ekzistencial dhe biologjik), dëmshpërblim që përfitojnë edhe familjarët në rast të vdekjes apo humbjes së aftësisë për punë të personave të dëmtuar. Kjo ndikon në rritjen e vlerës së dëmshpërblimit që përfiton i aksidentuari apo

familjari. Afti i trajtimit të dëmeve pasurore dhe jo-pasurore është zvogëluar.

Qendra e regjistrimit të të dhënave, e krijuar së fundmi, do shërbejë për mbajtjen dhe ruajtjen e të dhënave, si për kontrata të lidhura, ashtu dhe për aksidentet. Kjo qendër, hedh bazat për krijimin e një sistemi bonus malus në të ardhmen, ku tarifa e primit do jetë në funksion të disa të dhënave, përfshirë dhe aksidentet e shkaktuara.

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyruara

Vështrim mbi tregun e sigurimeve për vitin 2009


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për vitin 2009 arritën shifrën 7,889,428 mijë lekë përkundrejt 7,089,541 mijë lekë të realizuara në vitin 2008 ose 11.28 % më shumë.

Vihet re një ndryshim i strukturës së tregut të sigurimeve. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 47.31% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 52.69 % të tregut, ku në krahasim me vitet e mëparshme primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zinin pjesën më të konsiderueshme të tregut. Përsa i takon rritjes së tregjeve në veçanti, kemi një rritje në masën 39.79% të sigurimeve të Jetës dhe 9.04% të sigurimeve të Jo-Jetës.


Megjithë rritjen që shënuan sigurimet e Jetës, sërish 90.83% e primeve u gjenerua nga sigurimet e Jo-Jetës.

Gjatë vitit 2009 u nënshkruan rreth 755,669 kontrata sigurimi, ose rreth 9.15% më shumë se në vitin 2008.

Struktura e tregut të sigurimeve, viti 2009




Struktura e tregut të sigurimeve, viti 2009



Volumi i primit të shkruar bruto, viti (2008-2009)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë lekë)	
	2008	2009
Viti		
A) Sigurim i Jetës	517,652	723,648
B) Sigurim i Jo-Jetës	6,571,889	7,165,779
<i>Nga këto:</i>		
a) Sigurimi i Detyrueshëm	3,983,025	4,156,750
b) Sigurimi Vullnetar	2,588,863	3,009,030
TOTAL	7,089,541	7,889,428

Volumi i primit të shkruar bruto, viti 2009 (Jeta dhe Jo-Jeta)



Sigurimet e detyrueshme

Gjatë vitit 2009, sigurimet e detyrueshme motorike vazhduan të dominojnë strukturën e tregut, duke sjellë 52.69 % të të ardhurave nga primit e shkruara bruto të tregut të sigurimeve. Primit e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme, për vitin 2009, arritën 2,706,120 mijë lekë, ose 0.82 % më pak se në vitin 2008.

Në 2009, primit e shkruara bruto të kartonit jeshil ishin 1,046,546 mijë lekë, ose rreth 12.21 % më shumë se në 2008.

Primit e kontratës së sigurimit kufitar gjatë vitit 2009 arritën në 404,083 mijë lekë, apo 25.58 % më shumë se në vitin 2008.

Sigurimet vullnetare

Në vitin 2009, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në 3,732,678 mijë lekë, ose 20.16% më shumë se të ardhurat e të njëjtës periudhë të një viti më parë. Rritja e primeve në sigurimet vullnetare vazhdon të lidhet ngushtë me nivelin e kreditimit nga bankat dhe hyrjen e investitorëve të mëdhenj kryesisht në infrastrukturë.

Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës, me të ardhura 3,009,030 mijë lekë, vendin e parë e zunë sigurimet nga zjarri dhe rreziqet natyrore me rreth 27.26%, të pasuara nga sigurimi kasko me 20.55 % dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile me 20.79 %, dhe peshë më të ulët patën sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit si dhe sigurimet e garancisë.

Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe

shëndetit në vitin 2009 arritën në 374,969 mijë lekë, ose 19.72% më shumë se në vitin 2008. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e shëndetit në udhëtim me rreth 75.43% të të ardhurave të këtij grupi.

Primet në sigurimet e Jetës në vitin 2009 arritën në rreth 723,648 mijë lekë, ose rreth 39.79 % më të larta se në vitin 2008. Rritja në sigurimet e Jetës është e lidhur ngushtë me rritjen e nivelit të kredidhënies dhe sigurimit të Jetës për efekt kredie.

Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit


Tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës ndahet ndërmjet kompanive të sigurimit: Sigal, Sigma, Insig, Atlantik, Interlabian, Albsig, Intersig dhe Eurosig. Sigal udhëhoqi tregun me 30.53 % të primeve.



Aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan kompanitë Sigal Life, Insig dhe Sicred. Sigal-Life udhëhoqi tregun me 54.75% të primeve.

Dëmet

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në vitin 2009 kapi vlerën 1,751,860 mijë lekë, ose 13.05% më shumë se në vitin 2008. Për vetë strukturën e tregut të paraqitur më sipër, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara u përket sigurimit të detyrueshëm me 1,065,185 mijë lekë,



apo 60.80% të totalit. Gjatë vitit 2009, në sigurimet vullnetare, ndihet një rritje e vlerës së dëmeve të paguara në sigurimin e "Aksidente dhe shëndet" dhe "Kasko" përkatësisht 91.33% dhe 49.60%.

Raporti i ulët dëme / prime tregon se tregu ka shumë për të bërë në drejtim të përmirësimit të shërbimit ndaj klientit e publikut në tërësi.

Risigurime


Gjatë vitit 2009 primet nga aktiviteti i risigurimit

arritën rreth 72,059 mijë lekë, të cilat i përkasin portofoleve “Aksidente Personale” dhe “Kasko”.

Zhvilimet e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për vitin 2009

Tregu sekondar i letrave me vlerë të Qeverisë gjatë vitit 2009 u dominua në masën **89.41%** nga transaksionet në instrumenta afatshkurtër (*bono thesari*) dhe **10.59%** nga instrumenta afatgjatë (*obligacione*). Përsa I takon numrit të transaksioneve, **97.24%** e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera me bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të



letrave me vlerë të Qeverisë për vitin 2009, flasin për një dominim të transaksioneve “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” përkatësisht me **43.20%** dhe **32.13%** kundrejt volumit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë rreth **96.32%** të të gjitha transaksioneve në këtë treg, në raport me personat juridikë.

Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” gjatë vitit 2009 ka pasur një rritje prej 11.9 miliardë lekë ose në masën **140.81%**, krahasuar me vitin 2008, shoqëruar me një rritje në masën **14.25%** të numrit të transaksioneve.

Transaksioni i llojit C “Blerje nga individët para afatit të maturimit” gjatë vitit 2009 ka pasur një rritje prej 2.33 miliardë lekë ose **377.51%**, krahasuar me vitin 2008, ndjekur nga një rritje në masën **74.83%** të numrit të transaksioneve.

Krahasuar me vitin 2008, vihet re një rritje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C, të marra së bashku, me rreth **14.24** miliardë lekë.

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë 2008, 2009

Lloji i Transaksionit	Vlera nominale (në mijë lekë)		Ndryshimi (në %)
	2008	2009	
Periudha Janar - Dhjetor	2008	2009	'09/'08-1
Letra me Vlerë të Qeverisë			
B Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar	8,457.89	20,367.23	140.81
Individë	6,693.88	8,196.13	22.44
Persona juridike	1,764.00	12,171.10	589.97
C Blerje nga individët para afatit të maturimit	617.90	2,950.54	377.51
Individë	604.31	1,052.54	74.17
Persona juridike	13.59	1,897.99	13,871.25

Zhvillimet e tregut të pensioneve vullnetare private për vitin 2009

Tregu i pensioneve vullnetare mbetet ende një treg i vogël, parë ky si nga këndvështrimi i kontributeve dhe nga numri i kontribuesve. Në këtë treg, për vitin 2009, shihet një rritje prej 37.26% e kontributeve dhe një rritje prej afër 14.71% e numrit të kontribuesve, krahasuar me vitin 2008.

Zhvillimi më i rëndësishëm në këtë treg për vitin 2009, ka qenë hyrja në fuqi e Ligjit nr. 10 197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, i cili sjell përmirësimin e bazës ligjore për kolonën e tretë të fondeve private të pensionit vullnetar me kontribute të përcaktuara. Kuadri ligjor në fushën e pensioneve private paraqitet i vjetëruar

me Ligjin në fuqi nr. 7943, datë 01.06.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, i cili nuk përshtatej me standardet ndërkombëtare dhe direktivat evropiane.

Ligji i ri ka për qëllim përmirësimin e sistemit ekzistues të pensioneve vullnetare private në Shqipëri me ndikime të pritshme:

- lehtësim në planin afatgjatë të kostove sociale duke stimuluar shtetasit të kursejnë privatisht dhe vullnetarisht për të shtuar pensionin e tyre;
- shtimin e nivelit të kursimit të popullatës dhe rritjen e investimeve afatgjata në vend.

Më poshtë pasqyrohen disa të dhëna mbi tregun e pensioneve vullnetare private:

Tregu i Pensioneve Private Vullnetare viti 2008, 2009 (kontribute)

Shoqëria	Kontribute (në lekë)		Ndryshimi (në %)	Pjesa ndaj Totalit (në %)	
	2008	2009		2008	2009
Viti			'09/'08-1		
Raiffeisen PENSIONS	33,314,145	39,420,560	18.33	62.66	54.02
Capital	8,278,100	19,522,151	135.83	15.57	26.75
Sigma IPP	11,570,162	14,025,862	21.22	21.76	19.22
Total	53,162,407	72,968,573	37.26	100.00	100.00

Tregu i Pensioneve Private Vullnetare viti 2008, 2009 (kontribues)

Shoqëria	Numri kontribuesve		Ndryshimi (në %)	Pjesa ndaj Totalit (në %)	
	2008	2009		2008	2009
Viti			'09/'08-1		
Raiffeisen PENSIONS	1641	1679	2.32	42.50	37.91
Capital	1542	1774	15.05	39.94	40.05
Sigma IPP	678	976	43.95	17.56	22.04
Total	3861	4429	14.71	100.00	100.00

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

Zhvillohet seminari për Marrëveshjen Multilaterale të Mirëkuptimit me IAIS (Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve)

Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) në bashkëpunim me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare të Hungarisë (HFSA), zhvilloi në datën 29 janar 2010 në Budapest, seminarin për Marrëveshjen Multilaterale të Mirëkuptimit (MMoU) me IAIS.

Gjatë seminarit u trajtuan një sërë temash të rëndësishme, të cilat duhet të jenë në vëmendje të juridiksioneve që aspirojnë të bëhen nënshkrues të marrëveshjes. Seminari u hap me një panoramë të zhvillimeve ndërkombëtare në bashkëpunimin e rregullatorëve, duke vijuar më pas me kërkesat dhe procedurat administrative që lidhen me nënshkrimin e marrëveshjes. Seminari pati dhe një sërë prezantimesh dhe diskutimesh në aspektin praktik të çështjeve që lidhen me aplikimin si dhe eksperiencën të ndryshme nga vlerësimi i aplikimeve, të cilat u paraqitën nga ekspertë me eksperiencë në këtë fushë.

Objektiva e MmoU është, që të sigurojë një instrument për mbikëqyrësit, duke formuar një bazë formale për bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni midis Autoriteteve Nënshkruese, në lidhje me mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit, të cilat lidhen me aspekte të shkëmbimit të informacionit midis juridiksioneve. Pavarësisht se nënshkrimi i marrëveshjes dhe pjesëmarrja e sa më shumë juridiksioneve është e dëshirueshme, ajo nuk është detyruese, pasi në thelb të politikave të IAIS është promovimi i bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit midis anëtarëve të tij, ku bën pjesë dhe Shqipëria. Dispozitat e MmoU nuk kanë për qëllim të krijojnë detyrime ligjore apo të modifikojnë dhe të dominojnë mbi ligjet e juridiksioneve të

veçanta. Po kështu MmoU nuk krijon asnjë detyrim të zbatueshëm në mënyrë të drejtë apo të tërthortë.

Informacioni, që pritet të shkëmbehet në kuadër të marrëveshjes mbulon çështje që lidhen me mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit, si licencimi, mbikëqyrja e vazhdueshme dhe procesi i likuidimit. MmoU nuk adreson kërkesa për informacion, i cili është në dispozicion të publikut.

Parimet që lidhen me shkëmbimin e informacionit midis nënshkruesve të marrëveshjes, kryesisht fokusohen në:

- forcimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit në kuadër të mbikëqyrjes;
- dhënien e asistencës më të plotë të mundshme, në kuadër të funksioneve rregullatore, të cilat i nënshtrohen ligjeve të juridiksioneve përkatëse;
- seriozitetin dhe shpejtësinë e shkëmbimit të informacionit;
- mbështetjen ndaj përpikmërisë së zbatimit të regjimit të konfidencialitetit nga secili nënshkrues.

AMF si anëtare e IAIS, ka në axhendën e saj aplikimin për tu bërë nënshkruese e Marrëveshjes Multilaterale të Mirëkuptimit (MmoU) me IAIS, duke e vlerësuar si tepër të rëndësishëm procesin në tërësi dhe përfitimet që burojnë prej tij në drejtim të shkëmbimit të informacionit, si element kyç në forcimin e mëtejshëm të mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve. Ky aplikim do të vijë pas një sërë ndryshimesh ligjore, që duhen bërë në kuadrin ligjor të sigurimeve, në mënyrë që të harmonizohen kërkesat minimale, për tu kualifikuar në procesin e nënshkrimit të marrëveshjes.

Në përfundim të seminarit, të pranishmëve iu prezantua një plan pune i ardhshëm dhe roli i Sekretariatit të IAIS në lidhje me zbatimin e

kuadrit të marrëveshjes Multilaterale të Mirëkuptimit.

Në këtë seminar merrnin pjesë përfaqësues nga autoritete të ndryshme rregullatore.

Edukimi i konsumatorit

Drejtimi i brendshëm i shoqërive të sigurimit dhe administrimi i riskut

(Material i marrë nga botimi i Bankës Botërore "Mbikëqyrja e Bazuar në Risk", me autor Tony Randle, dhjetor 2009)

Mbikëqyrja e Bazuar në Risk, për Autoritetet Rregullatore të Sigurimeve

Roli i autoriteteve rregullatore që kanë detyrën e mbikëqyrjes së matur, është nxitja e mbajtjes së tregjeve efçente, të drejta, të sigurta dhe të qëndrueshme të sigurimeve, në të mirë dhe mbrojtje të policmbajtësve. Një autoritet mbikëqyrës i efektshëm është në gjendje t'i kërkojë një shoqërie sigurimesh marrjen e masave parandaluese dhe korrigjuese në kohë nëse kjo shoqëri nuk e ushtron aktivitetin në përputhje me praktikën e shëndosha tregtare apo me kërkesat rregullatore.

Historikisht, autoritetet e kanë kryer këtë rol përmes mbikëqyrjes së mbështetur në respektimin e kërkesave ligjore. Sipas kësaj mënyre mbikëqyrjeje, shoqëritë e sigurimit janë të detyruara të respektojnë një paketë normash mbikëqyrëse, të cilat, në përgjithësi, vendosen me ligj ose me akte nënligjore. Roli i autoritetit mbikëqyrës është të kujdeset që shoqëritë e sigurimit t'i respektojnë, në të vërtetë, këto norma. Gjatë viteve të fundit, mbikëqyrja është zhvilluar dhe ka kaluar, nga një mënyrë që mbështetet te respektimi i kërkesave, te mbikëqyrja e bazuar në risk. Kjo ka ndodhur edhe me veprimtaritë e mbikëqyrjes bankare dhe atë të pensioneve.

A. Çfarë është Mbikëqyrja e Bazuar në Risk?

Risku është zbulimi (ekspozimi) ndaj humbjes apo dëmit. Çdo aktivitet që kryejnë njerëzit e shoqëron një shkallë risku. Mbikëqyrja e Bazuar në Risk (MBR) kërkon që mbikëqyrësit të shqyrtojnë mënyrën me të cilën i identifikojnë dhe mbajnë në kontroll rreziqet shoqëritë e sigurimeve. Ajo kërkon që mbikëqyrësit të vlerësojnë riskun e sistemit dhe të firmave të veçanta dhe të kundërpërgjigjen përmes proceseve dhe ndërhyrjeve të vetë mbikëqyrësit në përputhje me vlerësimin. Kjo, nga ana e saj, u jep mundësi mbikëqyrësve t'ua shpërndajnë burimet siguruesve me riskun më të madh dhe atyre fushave brenda siguruesve të veçantë të cilat kanë risk të lartë. MBR kërkon që mbikëqyrësit të vlerësojnë katër faktorë: riskun e pranishëm, sistemet e kontrollit, riskun e mbetur dhe mbështetjen shtesë. Një shembull i thjeshtë, me një këmbësor i cili kalon në anën tjetër të rrugës, i shpjegon këto koncepte.

Risku i pranishëm është risku i ndodhjes së një ngjarjeje të pafavorshme. Risku i pranishëm mund të mos i jetë i njëjtë për veprimtari identike të kryera në rrethana të ndryshme. Në shembullin tonë, njëri prej rreziqeve të pranishëm për këmbësorin është risku se mos e shtyp makina. Risku i pranishëm do të ndryshonte nëse këmbësori do të kalonte një rrugë kryesore, në krahasim me një rrugë të parëndësishme, apo nëse do ta kalonte rrugën në mes të furtunës apo në orën me më shumë trafik. Shoqëritë e sigurimit përballen me një numër të madh rreziqesh të cilat duhet të tërheqin vëmendjen e mbikëqyrësit. Këto do t'i shohim më poshtë.

Sistemet e kontrollit janë ato veprime të parashikuara dhe të vendosura për ta ulur probabilitetin apo shkallën e riskut të pranishëm. Sistemet e kontrollit për zbutjen e riskut të shtypjes nga makina mund të jenë kalimi i rrugës vetëm kur është ndezur drita jeshile në kryqëzimet ku ka semaforë apo shikimi



nga të dyja anët përpara kapërcimit të rrugës. Shkalla me të cilën këto sisteme kontrolli e zbusin riskun ndryshon për secilin syresh.

Risku i mbetur është risku i ndodhjes së një ngjarjeje të pafavorshme edhe pas vendosjes dhe përdorimit korrekt të sistemeve të kontrollit. Një këmbësor shumë të kujdesshëm, i cili e kalon rrugën vetëm në semafor me dritë jeshile, mund ta shtypë makina, prapëseprapë, sepse vetë makina mund ta kalojë kryqëzimin me dritë të kuqe.

Mbështetja shtesë është çdo faktor shtesë i cili mund të ekzistojë për të trajtuar rezultatin e një ngjarjeje që ndodh dhe do ta zvogëlonte efektin e përgjithshëm të kësaj ngjarjeje. Këmbësori i pafat i shembullit tonë mund të ketë blerë sigurim nga aksidentet, i cili mund ta zvogëlojë efektin financiar të kësaj ngjarjeje, nëse ndodh. Edhe pse shpenzimet mjekësore të këmbësorit do të jenë po ato, humbja ekonomike që do të pësojë ai zvogëlohet nëse siguruesi ia paguan faturat mjekësore dhe i jep mbështetje me të ardhura gjatë kohës që ai merr veten.

Ka edhe një koncept tjetër të rëndësishëm, i cili duhet mbajtur parasysh në raport me rreziqet dhe sistemet e kontrollit. Çdo risk ka dy elementë, sa është *probabiliteti* që të ndodhë ngjarja dhe sa e *rëndë* do të ishte ngjarja po të ndodhte. MMR merr në konsideratë si elementin e probabilitetit ashtu edhe sa e rëndë është ngjarja, gjatë vlerësimit. Shikimi i të dy këtyre elementeve është i një rëndësie kritike për vlerësimin e sistemeve të kontrollit - sistemet e kontrollit mund ta ulin probabilitetin e ndodhjes së një ngjarjeje (për shembull, kalimi me dritë jeshile) ose mund t'i zbusin pasojat e rënda të ngjarjes së ndodhur (për shembull, mbajtja e veshjeve mbrojtëse mund ta zbusë goditjen nga makina), por në përgjithësi sistemet e veçanta të kontrollit nuk arrijnë të njëjtën zbutje të probabilitetit dhe pasojës së rëndë.

Në formë të përmbledhur, mbikëqyrja e Bazuar

në Risk vlerëson probabilitetin dhe shkallën e rreziqeve me rëndësi materiale të cilave u nënshtrohen siguruesit. Ajo vlerëson efektivitetin e sistemeve të kontrollit në lidhje me zvogëlimin e probabilitetit të ndodhjes së ngjarjeve dhe të pasojave të tyre nëse ndodhin. Ajo shikon edhe çfarë ka vendosur në funksionim siguruesi për të trajtuar ndodhjen e një ngjarjeje, edhe kur sistemet e kontrollit ekzistojnë dhe funksionojnë si duhet. *Risku i dështimit* mund të përkufizohet përafërsisht si shuma e të gjithë rreziqeve (pra, produkti i probabilitetit të ndodhjes së një ngjarjeje dhe i shkallës së pasojave nëse ndodh kjo ngjarje) minus vlerën e mbështetjes shtesë.

B. Cilat janë karakteristikat kryesore të MBR-së?

Në qasjen e mbështetur në respektimin e normave, veprimtaritë mbikëqyrëse përqendrohen te situata financiare e subjekteve të mbikëqyrura në një pikë të caktuar kohore. Përkundrazi, MBR është një proces dinamik, ku theksi vendoset më shumë te të kuptuarit dhe të dalit përpara rreziqeve të mundshme me të cilat do të përballet subjekti i mbikëqyrur gjatë zbatimit të planit të vet tregtar, pra duke shkuar përtej gjendjes së tanishme financiare. Për shembull, në MBR, mbikëqyrësi, gjatë marrjes në shqyrtim të planit tregtar të një siguruesi për futjen e produkteve të reja, do të përqendrohej më shumë te pasojat mbi kapitalin e siguruesit, nëse këto nisma dalin të pasuksesshme apo edhe nëse dalin tepër të suksesshme. Zbatimi i normave përqendrohet më shumë te fakti nëse e ka apo jo, tani për tani, kapitalin e mjaftueshëm siguruesi dhe nëse i ndjek apo jo normat që, mendohet, janë të mjaftueshme për të siguruar përmbushjen e objektivave të mbikëqyrjes. Në njëfarë kuptimi, mund të thuhet se MBR është më parandaluese.

Në përgjithësi, në MBR ka një shkallë më të madhe elasticiteti. Zbatimi i rregullave mbështetëse te rregullat që është i detyruar të respektojë siguruesi, ndërsa në kuadër të MBR-së

autoriteti përqendrohet më shumë te parimet. Nëse rregullat jepen në akte ligjore apo nënligjore, ka të ngjarë që përshtatja e tyre me zhvillimet e tregut të kërkojë shumë shpenzime dhe kohë. Një shembull interesant është blerja nga disa institucione e produkteve financiare shumë të vlerësuara por, megjithatë, shumë komplekse - njëra prej ngjarjeve që çoi në krizën financiare botërore të vitit 2008. Një qasje sipas MBR-së ka më shumë të ngjarë ta kishte identifikuar këtë anomali të dukshme midis vlerësimit të lartë të kredisë dhe normës së lartë të kthimit dhe do t'i kishte kërkuar siguruesit të vërtetonte se kishte kapital të mjaftueshëm për të qenë në gjendje t'i mbante këto instrumente. Qasja e mbikëqyrësit do të ishte mbështetur te vendosja e një pikëpyetjeje mbi faktin se përse instrumente të tjera me të cilat njihej dhe të cilat kishin norma të larta kthimi kishin një vlerësim të ulët kredie. Kjo analizë do të kishte zëvendësuar vlerësimin e riskut të kreditit të vendosur nga jashtë këtyre instrumenteve, të cilët tregu nuk i kuptonte. Një qasje e mbështetur te respektimi i normave do të ishte mbështetur më shumë te përcaktimi i normave në lidhje me instrumentet me vlerësim të lartë kredie.

Qasja tradicionale e mbështetur te respektimi i rregullave përqendrohet te një numër i kufizuar rreziqesh që u nënshtrohen rregullave. Zakonisht, këto janë risku i kreditit, i likuiditetit, i tregut dhe i sigurimit. Ngaqë MBR e hedh vështrimin nga e ardhmja, pikënisja për mbikëqyrësit është strategjia tregtare e siguruesit. Detyrimi për të kuptuar si duhet strategjinë tregtare të siguruesit i detyron mbikëqyrësit të marrin në shqyrtim edhe rreziqe të tjera, siç janë rreziqet e pranishme të strategjisë, risku që këshilli i administrimit dhe administratorët të mos jenë në gjendje ta realizojnë në mënyrë të efektshme strategjinë apo risku që këshilli i administrimit apo administratorët të mos jenë në dijeni të kufizimeve ligjore.

MBR merr në konsideratë edhe ato rreziqe që janë jashtë siguruesve të veçantë. Kur shohin

strategjinë tregtare të siguruesit, mbikëqyrësve u duhet të kuptojnë ekonominë, tregun e sigurimeve dhe veprimtaritë e konkurrentëve të siguruesit, si edhe rreziqet që lindin nga këta faktorë për siguruesin. Në përgjithësi, qasja e mbështetur te respektimi i rregullave nuk i merr në konsideratë këta faktorë sepse ajo mbështetet te rregullat për të gjithë sektorin e ekonomisë dhe jo te siguruesit e veçantë. Për shembull, kur një sigurues kërkon të zgjerojë linjat tregtare që ka, MBR mund të vendosë një kërkesë për kapital shtesë për t'i mbështetur këto linja mbi një sigurues i cili nuk ka kryer analizën e duhur të tregut, konkurrencës dhe rreziqeve dhe i cili nuk ka marrë masat për zbutjen e këtyre rreziqeve.

Parimi qendror i MBR-së është marrëdhënia midis rreziqeve dhe kapitalit - sa më i lartë profili i riskut i një siguruesi, aq më i lartë duhet të jetë niveli i kapitalit që ka. Nga këndvështrimi i siguruesit, kapitali i tepërt nuk është i dëshirueshëm, për shkak të kostove që ka marrja e kapitalit. Për rrjedhojë, siguruesit kanë një shtysë të konsiderueshme për të pasur një administrim të fortë të rreziqeve në mënyrë që të evitojnë mbajtjen e kapitalit shtesë. Një sigurues i cili u vendos një çmim më të ulët produkteve të veta, në krahasim me rreziqet që ka, për shkak se i duhet të konkurrojë me siguruesit me kosto më të ulëta, ka një risk të lartë sigurimi. Reagimi normal i autoriteteve në bazë të MBR-së është t'i kërkojnë këtij siguruesi ta rrisë nivelin e kapitalit të vet në mënyrë që t'i bëjë ballë këtij risku. Siguruesi ka përpara mundësinë e ngritjes së kapitalit ose të përmirësimit të praktikave të administrimit të riskut - me fjalë të tjera, harmonizimin më të ngushtë të primit me riskun, për të evituar "penalitetin" e kërkesës për kapital.

Të dyja qasjet mbikëqyrëse kërkojnë njëfarë testimi të transaksioneve - qasja e mbështetur te respektimi i rregullave u kërkon mbikëqyrësve të binden që siguruesit i respektojnë normat që ndonjëherë janë komplekse. MBR u kërkon

mbikëqyrësve të binden që siguruesit i respektojnë praktikat e tyre formale të administrimit të riskut. Në këtë proces, në kuadër të MBR-së, mbikëqyrësit kanë një pamje të plotë të siguruesit dhe i kuptojnë marrëdhëniet midis rreziqeve.

Qasjet e mbështetura te respektimi i rregullave kërkojnë një testim të gjerë të transaksioneve, kovalidimin e pasqyrave financiare, shqyrtimin e dosjeve të veçanta dhe verifikimin e aktiveve. Mbikëqyrja e mbështetur te respektimi i rregullave, deri në njëfarë shkalle, mund të krijojë mbivendosje të punës së audituesve të brendshëm dhe atyre të jashtëm.

MBR i jep mbikëqyrësit një kuadër formal për shpërndarjen e burimeve të pakta të mbikëqyrjes. Burimet mund të orientohen drejt atyre siguruesve të cilët paraqesin rreziqe më të larta në krahasim me homologët e tyre dhe mund të shpërndahen te ato fusha që kanë risk më të lartë brenda siguruesve të veçantë.

Në kuadër të MBR-së, ka një proces të përditësimit të vazhdueshëm të analizave të riskut përmes shqyrtimeve në vend, shqyrtimeve në zyrë dhe informatave të tregut, i cili krijon një sistem të “njoftimit të hershëm” ose “vlerësimit të riskut” përmes të cilit autoriteti mbikëqyrës u del përpara dhe i trajton çështjet që dalin. Për shembull, ndodhja e një ngjarjeje me risk të lartë për të cilën autoriteti është vënë në dijeni përmes lajmeve do ta shtynte t'i shikonte edhe një herë vlerësimet e riskut dhe gjendjet e kapitalit të gjithë siguruesve që shesin sigurime për atë risk.

Autoriteti mbikëqyrës mund të shikojë menjëherë se si ndryshon me kalimin e kohës profili i riskut i siguruesve të veçantë dhe i sektorit të ekonomisë në përgjithësi. Këto vëzhgime janë të dobishme, porë nga këndvështrimi i autoritetit për rishikimin e legjislacionit, ndërjegjësimin e hartuesve të politikave dhe diskutimet me organet e sektorëve të ekonomisë.

Autoritetet mbikëqyrëse mund t'i krahasojnë më saktë institucionet me homologët e tyre dhe me sektorin. Qasjet e mbështetura te respektimi i normave kanë më shumë të ngjarë të bëjnë krahasim mbështetur te madhësia e aktiveve, rritja e aktiveve apo fuqia e kapitalit. Nga këndvështrimi i autoritetit, parapëlqehet krahasimi mbështetur te risku.

MBR ka avantazhe, por ka edhe disa rreziqe shtesë. MBR kërkon mbikëqyrës me përvojë dhe njohuri, të cilët duhet të ushtrojnë në vazhdimësi gjykime subjektive. Qasjet e mbështetura te respektimi i normave kërkojnë që mbikëqyrësit të konstatojnë nëse i zbatojnë apo jo kërkesat ligjore siguruesit, pra bëhet fjalë për një vendim me “po ose jo”, ndërsa MBR u kërkon mbikëqyrëse të vlerësojnë “si” e menaxhon aktivitetin e vet tregtar siguruesi. Një vënie e suksesshme në jetë u kërkon autoriteteve të jenë të strukturuar si duhet për t'i trajnuar dhe drejtuar mbikëqyrësit për të siguruar një zbatim të njëtrajtshëm të parimeve të vlerësimit të riskut nga të gjithë mbikëqyrësit dhe të kenë mbikëqyrës më të trajnuar me njohuri për rreziqet tregtare dhe administrimin e tyre. Ky zbatim i suksesshëm nuk është një detyrë e lehtë dhe, përkundër avantazheve të cilat përmenden më lart, autoritetet kanë vënë re se u duhet ta zbatojnë me kujdes dhe maturi këtë qasje.

C. Si kryhet MBR?

Mbikëqyrësit e realizojnë MBR-në duke i parë të gjithë rreziqet me rëndësi materiale me të cilët përballet një sigurues, si edhe mënyrën me të cilën i mban nën kontroll këto rreziqe siguruesi. Mbikëqyrësit analizojnë pozicionin financiar të siguruesit në kuadër të riskut të mbetur dhe të aftësisë së tij për të gjetur kapital shtesë, nëse u duhet një gjë e tillë. Gjatë kryerjes së shqyrtimeve, kanë rëndësi shumë të madhe politikat, proceset dhe sistemet e siguruesit dhe përmbushja e tyre. Sigurues me risk të ulët është ai që ka politika dhe sisteme të shkëlqyera për zbutjen e rreziqeve dhe i vendos ato në zbatim

në mënyrë të efektshme gjithmonë dhe që ka kapital të mirë e mundësi të gjejë kapital shtesë nëse i duhet. Elementet e analizës vijnë nga shqyrtimet në vend dhe në zyrë dhe nga informacioni i përgjithshëm i tregut.

D. Cilat janë parakushtet për një MBR të suksesshme?

Që MBR të jetë e suksesshme, agjencitë mbikëqyrëse duhet të plotësojnë disa parakushte. Ka pesë elemente të cilat duhen mbajtur në konsideratë: situata e legjislacionit, struktura e agjencisë mbikëqyrëse, orientimi dhe trajnimi i mbikëqyrësve, modeli i vlerësimit të riskut dhe instrumenti i matjes. Do shikojmë secilin prej tyre.

Situata e legjislacionit

Parimi qendror i MBR-së është që mbikëqyrësit të luajnë një rol për të siguruar që siguresit të kenë kapital ose të mund të gjejnë kapital të mjaftueshëm lidhur me rreziqet e siguresit. Kur mbikëqyrësi nuk është i bindur që niveli i kapitalit është përpjesëtimor me rreziqet e një siguresi, ai duhet ta detyrojë siguresin ta zmadhojë kapitalin. Sigurisht, për ta bërë këtë, agjencisë mbikëqyrëse i duhet të ketë kompetenca të vendosura me ligj.

Krahas kësaj, duhet që autoriteti të ketë një varg kompetencash të shkallëzuara, në mënyrë që ndërhyrjet të jenë në përputhje me analizën e riskut. Mbikëqyrësit me kompetenca më të kufizuara mund të mos kenë mundësinë e veprimt të shkallëzuar sipas riskut.

Struktura e agjencisë mbikëqyrëse

Analizat e rreziqeve dhe cilësia e sistemeve të kontrollit janë subjektive. Subjektiviteti ndikohet nga qëndrimi që mbajnë personat ndaj riskut personal. Mbikëqyrësit që janë kundërshtues ndaj riskut i analizojnë ato më me rreptësi se mbikëqyrësit që nuk janë kundërshtues ndaj

riskut, në mënyrë që të zbusin riskun e nënvlerësimit. Po kështu, ata kanë të ngjarë ta nënvlerësojnë cilësinë e sistemeve të kontroleve, për të njëjtën arsye. Dy prej përparësive të MBR-së, për të cilën flitet më lart, janë aftësia për t'i krahasuar institucionet dhe për të parë si ndryshon me kalimin e kohës profili i riskut i një siguresi. Autoritetet mbikëqyrëse duhet të strukturohen në mënyrë të atillë që të sigurojnë një nivel të lartë njëtrajtshmërie, për t'i shfrytëzuar këto avantazhe. Një strukturë që ka pasur sukses në disa autoritete është caktimi i përgjegjësisë për mbikëqyrjen e siguresve e mbikëqyrësve të veçantë, nën drejtimin e një personi, i cili i mbikëqyr të gjithë siguresit dhe kundërfirmos në çdo analizë të rreziqeve dhe sistemeve të kontrollit. Kjo ka avantazhin shtesë që u kërkon mbikëqyrësve individë të fitojnë njohuri më të thella për siguresit të cilët mbulojnë. Njëtrajtshmërinë do ta rriste mbështetja e kësaj strukture me mekanizma të tjerë të kontrollit të cilësisë.

Trajnimi dhe orientimi për mbikëqyrësit

Për ta trajtuar edhe më tej mundësinë e mungesës së njëtrajtshmërisë, autoritetet duhet t'i kushtojnë vëmendje trajnimit fillestar dhe atij të vazhduar dhe dhënies së orientimit të hollësishëm mbikëqyrësve. Një formë e vlefshme orientimi është një varg përmbledhjesh, për mbikëqyrësit, lidhur me disa cilësi të një siguresi i cili, për shembull, ka risk shumë të lartë, të lartë, të mesëm, të ulët ose shumë të ulët në lidhje me secilën kategori risku. Orientimi duhet të përfshijë cilësitë e çdo pjese të mjedisit të kontrollit. Orientimi duhet t'u jepet mbikëqyrësve në seanca formale trajnimi. Mbikëqyrësit do të bëjnë kalimin nga analizat objektive të mbështetura te respektimi i normave, drejt analizave më subjektive të riskut; rrjedhimisht, trajnimi i vazhdueshëm ka rëndësi të madhe.

Modeli i klasifikimit të riskut

Rezultatet e të gjithë komponentëve të analizës së riskut përmbledhen në një model risku. Ky model, në përgjithësi, përmbledh secilin prej faktorëve të riskut dhe kontrollit, të matur, dhe i kondenson ato në një analizë të përgjithshme të riskut. Sofistikimi i modelit varet, në një shkallë të madhe, nga mënyra si vendos agjencia mbikëqyrëse t'i shprehë analizat. Modelet e thjeshta të riskut shprehin pasojat dhe probabilitetin e veçantë në terma cilësorë, domethënë “shumë i lartë, i lartë, i mesëm, etj.”. Modelet më të sofistikuara i shprehin pasojat dhe probabilitetin në terma cilësorë dhe sasiorë. Sigurisht, sa më shumë hollësi të ketë në matjet e para, aq më i vlefshëm do të jetë rezultati përfundimtar i krahasimit të siguruesve dhe i bërjes së dallimit midis tyre.

Gjithashtu, modelet më të sofistikuara të riskut mund t'u vendosin rreziqeve koeficientë ponderimi, për të pasqyruar faktin se rëndësia e rreziqeve të veçanta mund të jetë e ndryshme për sigurues të ndryshëm. Për shembull, një sigurues i cili cedon më shumë prime te një risigurues mund të ketë një risk kredie më të ndjeshëm dhe risk sigurimi më të ulët, se një sigurues i cili cedon më pak.

Në kuadër të analizimit të riskut të një shoqërie sigurimesh, vlen të përmendet roli që mund të luajnë agjencitë e vlerësimit të riskut. Agjencitë vlerësuese dhe MBR japin një pamje të riskut të një siguruesi. Për ata mbikëqyrës që përdorin MBR-në, vlerësimet e jashtme mund të ofrojnë një kovalidim shtesë vetëm ndaj modelit të vlerësimit të rreziqeve që përdor autoriteti. Nëse modeli kalibrohet si duhet, atëherë është e mundur të vërehet një korrelacion midis analizës që i ka bërë riskut mbikëqyrësi dhe vlerësimit të jashtëm të agjencisë, për shembull agjencitë mund t'i japin vlerësimin “AAA” ose “AA” një siguruesi, të cilin mbikëqyrësi e vlerëson me risk shumë të ulët, ose nga ana tjetër një sigurues të cilin mbikëqyrësi e ka vlerësuar me risk shumë të

lartë mund të vlerësohet nga agjencia me shkallën “nën-investim”. Megjithëse vlerësimet e kreditit nga agjencitë e jashtme mund të ndihmojnë në kontrollimin e kalibrimit të modelit të riskut që përdor një autoritet, ato nuk duhet të përdoren si zëvendësues të mbikëqyrjes së efektshme, siç e kanë treguar ngjarjet që çuan në krizën botërore financiare.

Instrumenti i matjes

Prej mbikëqyrësve pritet t'i analizojnë dhe komentojnë formalisht çdo risk të identifikuar dhe cilësinë e secilit prej sistemeve të kontrollit të administrimit. Në kuadër të MBR-së, nuk mjafton thjesht identifikimi i këtyre elementeve. Mbikëqyrësi duhet të kryejë një analizë të hollësishme. Prej mbikëqyrësve pritet të jenë në gjendje t'i justifikojnë vlerësimet që i kanë caktuar secilit risk dhe sistemi kontrolli. Autoritetet që hartojnë modele të mira e rrisin njëtrajtshmërinë midis vlerësimeve kur këto modele përdoren së bashku me materiale të plota udhëzuese.

E. Çfarë lloj rreziqesh duhet të marrë në shqyrtim mbikëqyrësi?

Kjo rubrikë nuk përpiqet të përcaktojë çdo risk ndaj të cilit është i ekspozuar një sigurues. Në të përkufizohen rreziqet që hasen më shumë dhe që merren në shqyrtim në shumicën e sistemeve ekzistuese të administrimit të riskut.

Risku strategjik është risku që shoqëron modelin tregtar dhe strategjinë tregtare të siguruesit. Për shembull, një sigurues i cili fut një linjë të re biznesi për të cilën nuk ka përvojë të mëparshme ose hyn në një segment tregu në të cilin nuk është përfaqësuar më parë mund të përballet me një risk të lartë strategjik, sepse tregu mund të mos e pranojë linjën e re të biznesit ose sepse siguruesi mund ta ketë të vështirë të hyjë në segmentin e ri. Në këtë rast, siguruesi përballet me mundësinë e humbjes së investimit për biznesin e ri dhe me riskun e dëmtimit të

reputacionit.

Risku i drejtimit të brendshëm dhe administrimit është risku që mund t'i lindë siguruesit nga paaftësia e Këshillit të Administrimit apo e Administratorëve për ta drejtuar si duhet siguruesin, si për shkak të mungesës së aftësisë ose për shkak të mungesës së ndershmërisë. Këshilli i Administrimit ka detyrën e marrjes së vendimit se sa risk do të merret përsipër, të përcaktimit të drejtimit për të ardhmen dhe të mbikëqyrjes së veprimtarive të siguruesit. Këshilli i administrimit duhet të vendosë në drejtpeshim interesat e aksionarëve dhe interesat e policmbajtësve. Mosvendosja e një drejtimi të arsyeshëm tregtar mund të çojë në një humbje financiare të konsiderueshme për siguruesin, ndërsa mosmbajtja si duhet në drejtpeshim e interesave të aksionarëve dhe të policmbajtësve mund të çonte në humbje të licencës dhe/ose penalitete të konsiderueshme financiare. Roli i Administratorëve është të vënë në jetë strategjinë e Këshillit të Administrimit përmes vendosjes së politikave dhe proceseve të duhura dhe përmes monitorimit të ecurisë së siguruesit në raport me to. Siguruesit mund t'i shkaktohen humbje të konsiderueshme nëse administratorët nuk i përmbushin si duhet përgjegjësitë e tyre.

Risku ligjor është risku që i lind siguruesit nga sistemi juridik në të cilin ushtron aktivitet. Sikundër edhe ndërmarrjet e tjera tregtare, siguruesit ushtrojnë aktivitet në një botë e cila i nënshtrohet një kombinimi të gjerë kërkesash ligjore, jo vetëm nga legjislacioni për sigurimet por edhe nga ligjet e fushave të ndryshme, ndër të tjera, të tatim-taksave, të punës, të shoqërive tregtare, të mbrojtjes së konsumatorit dhe të konkurrencës. Në shumë raste, mospërmbushja e kërkesave të këtyre ligjeve mbart në vetvete penalitete të rënda. Risku ligjor është risku që siguruesit t'i lindë një humbje nëse ai nuk është në dijeni të kërkesave ligjore të cilave u nënshtrohet ose nëse nuk i respekton ato.

Risku i likuiditetit është risku që siguruesi të mos i

administrojë si duhet flukset e veta monetare dhe, për rrjedhojë, të mos jetë në gjendje t'i përmbushë detyrimet e veta financiare brenda afateve. Nëse siguruesi nuk mund t'i përmbushë detyrimet e veta financiare, ekziston risku që Autoriteti mbikëqyrës t'ia heqë licencën, që të humbasë biznesin apo që t'i njolloset reputacionin. Risku i likuiditetit merr në konsideratë edhe riskun se siguruesit do t'i duhet të marrë fonde hua nga tregu me norma më të larta interesi se fondet e krijuara nga brenda (njësisë ekonomike) ngaqë nuk i ka administruar në mënyrë të efektshme flukset monetare hyrëse dhe dalëse.

Risku i kreditit është risku i mospërmbushjes së detyrimeve financiare nga të tretët te të cilët siguruesi ka interes financiar. Siguruesit kanë tri grupime personash të tretë me të cilët ka lidhje risku i kreditit. Shumica e siguruesve e kalojnë (cedojnë) një pjesë të biznesit të tyre te një ose më shumë risigurues. Kur paguajnë dëmet, sidomos dëme të mëdha, siguruesit mbështeten te mundësia që kanë për të marrë shlyerje në kohë nga risiguruesit për pjesën e tyre të dëmit. Grupi i dytë i të tretëve janë ato institucione te të cilët siguruesi mban aktivet e veta financiare. Krahas të ardhurave nga primet, siguruesit marrin një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave të tyre përmes investimit të fondeve jashtë tyre. Mospërmbushja e detyrimeve nga institucionet te të cilët ka investuar siguruesi apo nga risiguruesit ka një pasojë të rëndë te niveli i fitimit dhe i likuiditetit të siguruesit. Së treti, siguruesit që kanë klientë shoqëri të mëdha mund të sigurojnë sasi të mëdha për biznese të veçanta. Risku i kreditit ka të bëjë me ata klientë që nuk e përmbushin pagesën e këtyre primeve.

Risku i investimit është risku i humbjes së vlerës së aktiveve të një siguruesi për shkak të ndryshimeve të normave të interesit apo të faktorëve të tjerë. Shpesh quhet edhe risk tregu. Siguruesit kanë grupime aktivesh të cilët mbahen në instrumente financiare dhe aktive të tjera. Në rrethana të rralla, siguruesit mund të mbajnë aktive fizike, siç janë mallrat. Vlera e

këtyre aktiveve u nënshtrohet luhatjeve për shkak të ndryshimeve të normave të interesit dhe faktorëve të tjerë dhe kjo mund t'i sjellë humbje siguruesit. Risku i investimit ka të bëjë me riskun e lindjes së këtyre humbjeve. Siguruesit mund të mbajnë edhe aktive ose pasive të emërtuara në monedhë të huaj dhe u nënshtrohen ndryshimeve të vlerës së tyre kur ndryshojnë kurset e këmbimit të monedhave të huaja. Risku i kursit të këmbimit, i cili është një formë e riskut të investimit, ndonjëherë shqyrtohet më vete kur aktivet dhe pasivet e siguruesit të emërtuara në monedhë të huaj kanë rëndësi materiale.

Risku i sigurimit është risku që dëmet e pagueshme të jenë më të mëdha se kontributi i primeve të arkëtuara, me fjalë të tjera siguruesi shet sigurime me humbje në llogarinë teknike. Siguruesit i përcaktojnë primet në bazë të pritshmërisë që kanë lidhur me pagesën e dëmeve në të ardhmen. Gjatë caktimit të niveleve të primeve, siguruesit duhet të llogarisin vlerën aktuale të dëmeve të çmuara në të ardhmen për të cilën ata vetë janë të pasigurt dhe të vendosin një nivel primi i cili të paktën të arrijë pikën kritike. Niveli i primit që arrin pikën kritike është ai në të cilin vlera aktuale e primeve të ardhshme është e barabartë me vlerën aktuale të dëmeve të pritura dhe shpenzimeve të lidhura me operacionet. Gjatë realizimit të kësaj analize, ka dy të panjohura të rëndësishme, të cilat janë dëmet e ardhshme dhe norma e skontimit e përdorur për llogaritjen e vlerës aktuale. Risku i sigurimit është risku që këto llogaritje të mos jenë të sakta dhe t'i sjellin siguruesit humbje teknike. Ndonjëherë, ky quhet edhe risk i nënshkrimit të sigurimeve.

Risku operativ është risku që i lind siguruesit nga sistemet, proceset dhe procedurat e veta të brendshme. Duhet thënë se sistemet, proceset dhe procedurat e brendshme, nuk janë vetëm teknologjia por përfshijnë çdo dimension të

operacioneve të biznesit, në të cilat ekziston mundësia e gabimit, mashtrimit apo defektit, shkaktuar ose nga ngjarje të brendshme ose nga ngjarje të jashtme. Nëse ka një mosfunksionim, atëherë mund të ketë një ndërprerje të konsiderueshme të biznesit, humbje të biznesit dhe kosto, të cilat lindin për korrigjimin apo zëvendësimin e sistemeve mosfunksionuese.

Vijon në numrin tjetër...

Për këtë numër punuan:

E. Shehi, R. Guri, F. Hebovija,
R. Eltari, E. Kokona

